

RAPORT NARRATIV

VLERËSIMI NGA STUDENTËT PËR MËSIMDHËNIE, MËSIMNXËNIE, ADMINISTRATË, SHËRBIME DHE INFRASTRUKTURË

Viti akademik 2024 – 2025

Periudha e vlerësimit : Maj, 2025

Numri i studentëve pjesëmarrës: 13

Përmbledhje e Përgjithshme

Rezultatet e pyetësorit tregojnë një mesatare të përgjithshme 4.28, që interpretohet si niveli shumë i lartë i kënaqshmërisë së studentëve me administratën, shërbimet mbështetëse dhe infrastrukturën e institucionit.

Studentët kanë vlerësuar në mënyrë pozitive komunikimin me administratën, pastërtinë, kushtet mësimore dhe pajisjet teknike. Në disa fusha si pasurimi i bibliotekës dhe komunikimi i brendshëm, vërehet hapësirë për përmirësim.

Disa nga imputet kyçe të vlerësimit:

- Staf i administrativ është i sjellshëm dhe bashkëpunues me studentët – 12 nga 13 studentë (92%) pajtohen ose pajtohen plotësisht. Administrata perceptohet si e qasshme dhe e gatshme për ndihmë.
- Informacionet për çështjet akademike jepen me kohë – 11 nga 13 (85%) pajtohen. Ka transparencë të mirë, por disa studentë kanë përmendur vonesa sporadike në njoftime.
- Procedurat administrative janë të qarta dhe të lehta për t'u ndjekur – 10 nga 13 (77%) pajtohen. Studentët ndihen të orientuar, por disa sugjerojnë automatizim më të madh të proceseve përmes SEMS.
- Materialet e prezantuara gjatë ligjëratave na jepen rregullisht – 13 nga 13 (100%) pajtohen plotësisht.
- Klasat janë të pajisura me mjetet e nevojshme për mësim – 12 nga 13 (92%) pajtohen.
- Ambienti i kolegjit është i pastër dhe i mirëmbajtur – 13 nga 13 (100%) pajtohen plotësisht.
- Materialet e prezantuara gjatë ligjëratave na jepen rregullisht – 13 nga 13 (100%) pajtohen plotësisht.
- Klasat janë të pajisura me mjetet e nevojshme për mësim – 12 nga 13 (92%) pajtohen.
- Ambienti i kolegjit është i pastër dhe i mirëmbajtur – 13 nga 13 (100%) pajtohen plotësisht.

- Institucioni ofron përkujdesje shëndetësore për studentë – 11 nga 13 (85%) pajtohen.
- Institucioni ofron përkujdesje shëndetësore për studentë – 11 nga 13 (85%) pajtohen.
- Literatura e sugjeruar për lëndët na bëhet e ditur që në fillim të semestrit – 13 nga 13 (100%) pajtohen.
- Biblioteka dhe burimet online janë të mjaftueshme për studim – 9 nga 13 (69%) pajtohen.
Ekziston nevojë për pasurim të materialeve digjitale dhe librave në gjuhë të huaj.
- Studentët ndihen të informuar për vendimet që ndikojnë në studimet e tyre – 9 nga 13 (69%) pajtohen.
- Institucioni i inkurajon studentët të marrin pjesë në aktivitete jashtë mësimore – 10 nga 13 (77%) pajtohen.

Studentët e perceptojnë administratën si efikase dhe profesionale, me nevojë për rritje të komunikimit të vazhdueshëm dhe digjitalizim të procedurave. Infrastruktura dhe higjiena vlerësohen shumë lartë. Studentët theksojnë ambient të rregullt dhe kushte të mira për mësim. Sugjerohet shtim i hapësirave për pushim dhe studim individual. Studentët shprehin kënaqësi të përgjithshme, por rekomandojnë përmirësime në qasjen digjitale të literaturës dhe materialeve ndihmëse. Komunikimi është në nivel të mirë.

Komentet e Hapura të Studentëve

Nr	Komenti
8	nuk kam me shtu kurgjo
9	Orari sme pelqen se punoj
10	Kisha pas qef ligjeratat ni dite

Përmbledhje:

Shumica e studentëve nuk kanë dhënë komente shtesë, gjë që tregon kënaqësi të përgjithshme. Disa përgjigje përmbajnë shenja të shkurtra ose komente neutrale (“nuk kam me shtu kurgjo”), pa kritika konkrete por me sygjerime për orar gjithë ditës.

7. Përfundime dhe Rekomandime

1. Të ruhet niveli i lartë i komunikimit dhe bashkëpunimit me studentët.
2. Të investohet në pasurimin e bibliotekës dhe burimeve digjitale.
3. Të vazhdohet përmirësimi i sistemeve digjitale të administratës (SEMS, njoftime online)
4. Të shikohet mundësia e orarit gjithëditor.

Vlerësimi përfundimtar: 4.28 / 5

Numri i studentëve pjesëmarrës: 13

Statusi: Niveli shumë i lartë i kënaqshmërisë dhe besimit të studentëve ndaj institucionit.